



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 30.1.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.1.2012,**
3. **Shqyrtimi i Planit të punës për 2012,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime me sugjerimin se mund të shqyrtohen edhe disa çështje tjera.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.1.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23.1.2012.

3. Shqyrtimi i Planit të punës për 2012

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin për bisedën me Kryetarin e Kuvendit i cili ka sugjeruar shtimin e fondit vjetor të komisionit, nëse ka nevojë. Pasi që u shqyrtuan shtesat që janë bërë në planin e punës (bashkë me planin buxhetor), komisioni miratoi planin e punës për vitin 2012, gjithashtu edhe raportin e punës për vitin 2011. Gjatë diskutimit për raportin, u theksuan disa çështje të cilat mund të shfaqen si problematika në punën e komisionit, sidomos me parkun e Sharrit (**Daut Haradinaj**) ku duhet të angazhohen sipas tij profesionist shumë serioz, ngase në këtë projekt që është ofruar janë përfshirë edhe gjëra banale siç janë fshatrat etj, çka do të thotë se duhet të pritet nga MMPH të formoj një departament për të analizuar më tutje gjërat si duhet të veprohet, kjo është absurde. **Afërdita Berisha** gjithashtu konstatoi se është e pamundur konstatimi se p.sh. Dragashi 57% është e mbrojtur. **Nait Hasani** njoftoi komisionin për takimin me zyrtarët e binjakëzimit të Kuvendit të cilët do të përkrahin iniciativën për të vizituar komisioni Austrinë, si vend tipik për të krijuar komisioni përvojën e duhur për këtë lëmi rreth parqeve, por paraprakisht është kërkuar sqarimi për financimin e vizitës nga zyrtarët e KE. **Liburn Aliu** u angazhua për vizitën e komisionit në vendin e regjionit Bullgarinë ngase nga ky vend komisioni do të përfitojë më tepër përvoja, ngase në këtë shtet janë krijuar përvojat nga degradimet që janë bërë pyjeve, janë krijuar pikat kontrolluese, të cilat në Austri nuk ekzistojnë. Në këtë drejtim diskutoi edhe **Nijazi Idrizi** i cili konstatoi se megjithatë Austria është më e nevojshme për përvojën e komisionit. **Daut Haradinaj** tha se pyjet nuk shkatërrohen vetëm nga prerjet ilegale ngase janë viruset ato që bëjnë dëme edhe më të mëdha nëse nuk ka preventiv, për projektin e Bjeshkëve të Nemuna konstatoi se më parë është një deklaratë politike sesa një ligj, ai sugjeroi Austrinë për vizitë. Në projektin e cekur **Afërdita Berisha** tha se përfshihen defekte menaxhuese. **Liburn Aliu** konstatoi se komisioni duhet të angazhohet rreth funksionit të agjencisë së pyjeve e cila pasi që është centralizuar, ajo duhet të centralizoi edhe funksionin e kontrollit, sepse inspektimi zbulon shumë defekte aktuale, pra dyjat të shkojnë bashkë. **Nait Hasani** duke parë se janë të dobishme dy vizitat, në Austri dhe në Bullgari, propozoi të bëhen të dyjat, duke kërkuar mbështetjen e nevojshme, opsionet mbeten të hapura rreth vizitave të komisionit.

4. Të ndryshme

Komisioni në vazhdim shqyrtoi dhe vendosi :

- pasi që u diskutuan disa probleme në projektligj rreth themelimit të agjencisë së pagesave (është më mirë të themelohet apo jo) u formua grupi punues për p/l e bujqësisë dhe zhvillimit rural : **Nijazi Idrizi, Liburn Aliu, Salih Morina, Nait Hasani dhe Etem Arifi.**
- ekspertiza për p/l e mbeturinave do të shqyrtohet të martën më 7 shkurt kur do të ftohet eksperti me zyrtarët e MMPH.
- Projektligji për QHP do të shqyrtohet të premtën më 3 shkurt bashkërisht me ministrin e MMPH,
- të hënën më 6 shkurt mbahet mbledhja e përbashkët me komisionin për buxhet rreth projektit për agjencinë e rrezatimeve.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,15.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani